



**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti Shkencave Matematike Natyrore

Lëndët/Pozitat: Gjeografia ekonomike (O) Bsc, Pedogjeografia (O) Bsc, Gjeoekonomia (O) Msc, Metodatat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike (O) Msc, Gjeostatistika (O) Bsc, Gjeografia e transportit (Z) Bsc.

1. Msc. Albert Berila

Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtareve):

1. **Kryetar Prof. Dr. Florim Isufi**
2. **Anëtar Prof. Asoc. Dr. Shpejtim Bulliqi**
3. **Anëtar Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli**


Kandidatët e paraqitur sipas pozitave/lëndëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rendor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitave apo kandidatëve):

Pozita/lëndët: 1. Gjeografia ekonomike (O) Bsc, Pedogjeografia (O) Bsc, Gjeoekonomia (O) Msc, Metodatat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike (O) Msc, Gjeostatistika (O) Bsc, Gjeografia e transportit (Z) Bsc.

1. Msc. Albert Berila

RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Me analizën e dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se kandidati MSc. Albert Berila i plotëson të gjitha kushtet e parapara me statutin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe rregullores për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 2/254 datë 17.07.2024, që të angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime në lëndët: **Gjeografia ekonomike (O) Bsc, Pedogjeografia (O) Bsc, Gjeoekonomia (O) Msc, Metodatat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike (O) Msc, Gjeostatistika (O) Bsc, Gjeografia e transportit (Z) Bsc** për vitin akademik 2024/2025. Kandidati MSc. Albert Berila në vitin akademik 2023/2024 ka qenë i angazhuar në lëndët e lartcekura dhe ka treguar profesionalizëm të lartë akademik. Kandidati MSc. Albert Berila paraqet potencial profesional dhe shkencor në trend me zhvillimet metodologjike hulumtuese bashkëkohore. Kjo është konstatuar me numrin e madh të punimeve shkencore të cituar gjithandej. Kandidati, deri me tani, ka të publikuara si autor i parë dhe/apo



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

autor korrespondent gjithsej **8 punime** shkencore, të indeksuara në platformat shkencore ndërkombëtare “Scopus” dhe “Web of Science”, **4 punime dhe pjesëmarrje** në konferencat ndërkombëtare, bashkëpunëtor i **1 projekti**, mirënjohje “student i dalluar” në FSHMN, 2 bursa universitare të UP-së dhe 2 bursa të “Student i elitës” në Universitetet publike të Kosovës nga MASHT. MSc. Albert Berila ka aftësi të larta bashkëpunimi me kolegë, profesorë dhe studentë. Gjatë vitit akademik 2023/2024, sa ishte i angazhuar si bashkëpunëtorë në Departamentin e Gjeografisë, pranë FSHMN-së, ka treguar rezultate të larta në ushtrime si dhe në përcjelljen e teknikës hulumtuese bashkëkohore tek studentët. Kandidati MSc. Albert Berila është njohës i shumë programeve kompjuterike profesionale, nga ato të GIS-it e deri tek programet më të avancuara në shkencën e gjeografisë, si Remote Sensingut dhe gjeostatistikave. MSc. Albert Berila ka përfunduar edhe shumë trajnime, ndër të cilat edhe dy nivelet e organizuara nga Qendra për përsosmëri në mësimdhënie, UP “Hasan Prishtina”, “Mësimdhënia në arsimin e lartë”, dhe “Planifikimi dhe implementimi i mësimdhënies në arsimin e lartë”. Kandidati MSc. Albert Berila është edhe njohës i mirë i gjuhës angleze.

Bazuar në të gjitha ato që u ceken më lartë dhe përgatitjen profesionale, i propozohet Këshillit të fakultetit që kandidatin MSc. Albert Berila ta zgjedh në pozitën **bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime** në lëndët: **Gjeografia ekonomike (O) Bsc, Pedogjeografia (O) Bsc, Gjeoekonomia (O) Msc, Metodat dhe analiza e përpunimit të të dhënave gjeografike (O) Msc, Gjeostatistika (O) Bsc, Gjeografia e transportit (Z) Bsc.**

(Raporti përmbledhës duhet të përmbaj përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).

Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtareve):

1. **Kryetar Prof. Dr. Florim Isufi**
2. **Anëtar Prof. Asoc. Dr. Shpejtim Bulliqi**
3. **Anëtar Prof. Ass. Dr. Fitim Humolli**

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCËVE MATEMATIKË-NATYRORE
PRISHTINË

Prenuar me: 28.08.2024			
Nj. org.	Numër	Sasia	Vlera
01	2875	3	—